



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith, III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 16 dhjetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër mbi Riklasifikimet dhe Versionet Publike të Redaktuara

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Valeria Boliçi

Mathju Halling

Xhejms Paç

Mbrojtjes së Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Hju Bauden

Elinor Stivenson

Mbrojtjes së Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Karl Bakli

Xhonathan Piter Uorbois

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21(2), 40(2), (4) dhe (6)(h) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 82(5) dhe 116(1) të Rregullores së Procedurës dhe Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), nxjerr këtë urdhër.

I. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

1. Në bazë të neneve 21(2) dhe 40(4) të Ligjit, seancat janë publike, përveçse kur Trupi Gjykues përkatës vendos ndryshe në pajtim me Rregulloren.
2. Në pajtim me rregullën 82(5) të Rregullores, kur arsyet për riklasifikimin pushojnë së ekzistuari, dorëzuesi i parashtrimit të parë të protokolluar i paraqet kërkesë Trupit Gjykues për riklasifikim. Trupi Gjykues mundet edhe ta riklasifikojë statusin e një parashtrimit të protokolluar me kërkesë të një pjesëmarrësi tjetër në proces apo *proprio motu*.
3. Në pajtim me rregullën 84(1) të Rregullores, në mënyrë të vazhdueshme dhe përpara se të nxjerrë aktgjykimin, Trupi Gjykues rishikon klasifikimin e dokumentacionit të procesit gjyqësor dhe, kur është e zbatueshme, urdhëron riklasifikimin e tij.

II. DISKUTIM

4. Në pajtim me rregullën 84(1) të Rregullores, Trupi Gjykues e gjykon të nevojshme të rishikojë klasifikimin e disa parashtrimeve të protokolluara në dosjen e çështjes, në mënyrë që të respektohet parimi i procesit publik, i cili vlen jo vetëm për seancat në

sallën e gjyqit, por edhe për parashtrimet e protokolluara dhe çdo material tjetër në dosjen e çështjes.¹

5. Në këtë kontekst, vëmendje duhet t'i kushtohet, nga njëra anë, parimit të gjykimit publik, siç përcaktohet në nenet 21(2) dhe 40(4) të Ligjit, dhe në anën tjetër detyrës së Trupit Gjykes për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve dhe informacionin konfidencial.² Rrjedhimisht, Trupi Gjykes ka përgjegjësinë të sigurojë që çdo parashtrim i protokolluar në këtë çështje të ketë klasifikimin e duhur dhe, në përputhje me këtë, të riklasifikojë çdo parashtrim të protokolluar *proprio motu* ose në bazë të një kërkesë, nëse arsyet për klasifikimin aktual nuk ekzistojnë më.³

6. Në pajtim me nenet 23 dhe 62 të Ligjit, rregullën 80 të Rregullores dhe nenin 33 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet e Parashtrimet e Protokolluara, Trupi Gjykes u kujton palëve që versionet e redaktuara publike të parashtrimeve duhet të heqin çdo informacion që zbulon: (i) emrin, identitetin ose të dhënat e tjera personale të punonjësve të ZPS-së (që nuk janë dëshmitarë në këtë çështje) dhe të individëve të përmendur në dokumentet e sekuestruara apo të marra në paketa të ndryshme;⁴ (ii) organizatat ose subjektet që bashkëpunojnë me ZPS-në mbi baza konfidenciale; (iii) dokumentet ose pjesë të tyre që i janë dhënë Mbrojtjes në mënyrë konfidenciale; dhe (iv) përmbajtjen e çdo dokumenti tjetër konfidencial sipas urdhrave të Dhomave të Specializuara.⁵

7. Duke marrë parasysh sa më lart, Trupi Gjykes urdhëron Zyrën Administrative të riklasifikojë parashtrimet e mëposhtme si **publike**:

¹ F00225, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Urdhër për Parashtrime lidhur me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara* ("Urdhri i Gjykatësit të Procedurës Paraprake"), 10 qershor 2021, para. 8.

² Urdhri i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 9.

³ Urdhri i Gjykatësit të Procedurës Paraprake, para. 10.

⁴ Transkripti, 6 dhjetor 2021, f. 2146-2147 (përveç emrit të përmendur në transkript që është lejuar të përmendet në seancë të hapur).

⁵ F00328, Trupi Gjykes, *Urdhër mbi Mocionet e Mbrojtjes sipas Rregullës 117*, 27 shtator, para. 16.

- F00289, 27 gusht 2021;⁶
- F00320, 22 shtator 2021;
- F00326, 24 shtator 2021;
- F00336, 29 shtator 2021;
- F00340, 30 shtator 2021;
- F00346, 1 tetor 2021;
- F00354, 7 tetor 2021;
- F00355, 8 tetor 2021;
- F00364, 14 tetor 2021;
- F00386/A01, 20 tetor 2021;⁷
- F00394, 23 tetor 2021;⁸
- F00420, 5 nëntor 2021;
- F00441, 18 nëntor 2021;
- F00443, 18 nëntor 2021;
- F00493, 13 dhjetor 2021;
- F00494, 13 dhjetor 2021.

8. Trupi Gjykses urdhëron Zyrën Administrative të paraqesë një version të redaktuar publik ose të kërkojë riklasifikimin si publik të parashtrimit të protokolluar F00310, të dorëzuar më 10 shtator 2021 dhe që aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.

⁶ F00473, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrime në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 6 dhjetor 2021.

⁷ F00473, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrime në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 6 dhjetor 2021.

⁸ F00473, Mbrojtja e Haradinajt, *Parashtrime në lidhje me Riklasifikimin e Parashtrimeve të Protokolluara*, 6 dhjetor 2021.

9. Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në të paraqesë versionet publike të redaktuara të parashtrimeve konfidenciale në vijim ose të kërkojë nëse mund të riklasifikohen si publike:

- F00327, 27 shtator 2021;
- F00409, 1 nëntor 2021;

10. Përveç kësaj, Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në të paraqesë një version konfidencial dhe të redaktuar publik të parashtrimit F00331, të dorëzuar më 28 shtator 2021 dhe që aktualisht është i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Gjithashtu, Trupi Gjykues urdhëron ZPS-në të paraqesë një version konfidencial të redaktuar të parashtrimit F00337 më 29 shtator 2021, që aktualisht është i klasifikuar si rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

11. Trupi Gjykues urdhëron Mbrojtjen e Gucatit të paraqesë një version të redaktuar publik ose të kërkojë riklasifikimin si publik të parashtrimit të protokolluar F00436, të dorëzuar më 15 nëntor 2021 dhe që aktualisht është i klasifikuar si konfidencial.

12. Trupi Gjykues më tej urdhëron Mbrojtjen e Gucatit të paraqesë versionet publike të redaktuara të parashtrimeve konfidenciale të veta në vijim:

- F00325/COR, 24 shtator 2021, duke i bërë redaktimet në përputhje me klasifikimin e parashtrimit F00307/A01 dhe përmbajtjen e versionit të redaktuar publik të parashtrimit F00316;
- F00406/COR, 29 tetor 2021;
- F00407, 29 tetor 2021, duke i bërë redaktimet në përputhje me klasifikimin e parashtrimit F00361 dhe përmbajtjen e versionit të redaktuar publik të parashtrimit F00389;

13. Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Haradinajt të paraqesë versionet publike të redaktuara të parashtrimeve të veta konfidenciale në vijim ose të kërkojë riklasifikimin e tyre si publike:

- F00461, 29 nëntor 2021;
- F00491, 13 dhjetor 2021.

14. Trupi Gjykses më tej urdhëron Mbrojtjen e Haradinajt të paraqesë një version publik të redaktuar të parashtrimit F00404, dorëzuar më 27 tetor 2021 dhe aktualisht i klasifikuar si konfidencial, duke i bërë redaktimet në përputhje me klasifikimin e parashtrimit F00361 dhe përmbajtjen e versionit të redaktuar publik të parashtrimit F00389.

15. Gjithashtu, Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen e Haradinajt të paraqesë një version publik të redaktuar të parashtrimit F00471/A02, pasi të ketë redaktuar informacionin në paragrafët 68, 75, 76, 94, 95, 99, 114, 115, 116 dhe 118, dhe çdo informacion tjetër sipas paragrafit 6 të këtij vendimi.

16. Trupi Gjykses vëren se shtojcat mbulohen nga urdhrat e mësipërm vetëm kur ato përmenden shprehimisht.

III. VENDIM

17. Për arsyet e lartpërmendura, Trupi Gjykses:

- a. **URDHËRON** Zyrën Administrative të riklasifikojë si publike parashtrimet e përmendura në paragrafin 7;
- b. **URDHËRON** Zyrën Administrative të dorëzojë parashtrimin ose kërkesën përkatëse të përmendur në paragrafin 8 deri më **17 janar 2022**

- c. **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë parashtrimet ose kërkesat përkatëse të përmendura në paragrafët 9-10 deri më **17 janar 2022**;
- d. **URDHËRON** Mbrojtjen e Gucatit të dorëzojë parashtrimet ose kërkesat përkatëse të përmendura në paragrafët 11-12 deri më **17 janar 2022**; dhe
- e. **URDHËRON** Mbrojtjen e Haradinajt të dorëzojë parashtrimet ose kërkesat përkatëse të përmendura në paragrafët 13-15 deri më **17 janar 2022**.

_____/nënshkrim/_____

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 16 dhjetor 2021

Hagë, Holandë.